

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	616-22-2865-2-1-2
Nr i brendshëm	616 22 031 212

Sa i përket tenderit për *Shërbime profesionale në procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje*

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Consult Engineering sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Shaqir Kuka, pn.

(Adresa)

Kaçanik

(Vendi)

71000

(Kodi postar)

044431224

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jakup Kuka

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@consult-eng.com

(Adresa elektronike)

18/05/2022

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe mulla)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

***Njoftimi për kontratë me datë 07.04.2022***

***Kriteri për dhënien e kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët***

***Kërkesa për rishqyrtim e datës 13/05/2022***

***Vendim/Përgjigja e AK, datë 16/05/2022***

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☐

Data e fundit për dorëzim të tenderëve është 20.05.2022

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 13/05/2022 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ku kemi pasqyruar në mënyrë të qartë të gjitha argumentet tona se AK në disa prej kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale (neni 8.1 & 8.2 ne FTD te dosjes se tenderit) ka bërë shkelje të Ligji Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), Neni 7, Neni 28, Neni 69, Neni 108/A dhe neni 3.1 i “F03 Rregullat për parashtrim të ankesave”. Me datë 16/05/2022 AK ka dërguar vetëm tek ne vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim, ku ka refuzuar kërkesën tonë si të pa bazuar.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Autoriteti Kontraktues – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** permes njoftimit per kontrate te datës 07.04.2022 dhe vendimit per refuzim te kërkesës per rishqyrtim te datës 13.05.2022, ka shkelur dispozitat, si ne vijim:

Ligji Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar):

- Neni 7,
- Neni 28,
- Neni 69,
- Neni 108/A, paragrafi 2 dhe
- Neni 108/A, paragrafi 9.

“F03 Rregullat për parashtrim të ankesave”

- neni 6 dhe neni 7.2

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### 1) Pretendimet ankimore dhe faktet mbi shkeljet ligjore në vendimin e AK (datë 16/05/2022) për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim (datë 13/05/2022):

**(Pretendim 1):** Me mënyrën se si AK e ka trajtuar Kërkesën për Rishqyrtim ka bërë shkelje të LPP-së, neni 108/A, paragrafin 2, sepse AK nuk ka pezulluar procedurën e tenderimit ashtu siç kërkon neni në fjalë, *citojmë:*

*2. Dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*

**(Pretendim 2):** AK ka dërguar vendimin për refuzim vetëm tek ne si OE që kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim, por nuk e ka publikuar atë, rrjedhimisht ka shkelur LPP, nenin 108/A, paragrafi 9, *citojmë.*

*9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.*

**(Pretendim 3):** Në lidhje me dy pretendimet si më sipër, AK gjithashtu bënë shkelje edhe të “F03 Rregullat për parashtrim të ankesave”, gjegjësisht nenit 6.1, paragraf b) dhe nenit 7.2, *citojmë:*

*6.1 Ushtrimi i kërkesës për rishqyrtim **automatikisht pezullon** procedurën e prokurimit dhe në këtë rast Autoriteti Kontraktues, **respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit**, duhet të njoftoj me shkrim të **gjitha palët e interesuara** lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.*

**a)** *Kurdo që pezullimi i përmendur ndërlidhet me vendimin **për shpërblim të një kontrate**, pezullimi i tillë nuk do të përfundojë para skadimit të një periudhe prej të paktën 10 ditë*

*kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka dhënë një përgjigje.*

- b) *Kurdo qe pezullimi i përmendur ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, pezullimi i tillë do të përfundojë menjëherë pas nxjerrjes së vendimit nga ana e Autoritetit Kontraktues, respektivisht Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.*

**7.2 Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.**

Për më tepër, arsyetimi i paraqitur në vendimin e AK është i çuditshëm pasi nuk ndërlidhet konkretisht me pretendimet tona ankimore, por me pyetje të operatorëve tjerë ekonomik. Pra, AK në arsyetimin e vendimit të saj në asnjë rast nuk kundërshton ndonjërin nga pretendimet tona ankimore, por i kundërshton ato si të përgjithësuara dhe aspak të bazuara në LPP. AK në një mënyrë akuzon në si OE pse nuk kemi bërë kërkesë për informacione shtesë. AK duke shkelur LPP, nenin 108/A, bënë ndërlidhje të dy çështjeve krejtësisht të ndara, pra, të kërkesës për informacion shtesë, e cila përkufizohet sipas nenit 53 të LPP, dhe Kërkesës për Rishqyrtim, e cila përkufizohet sipas nenit 108/A. Duke parë se AK përveç që ka bërë shkelje ligjore në vendosjen e disa prej Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale (neni 8.1 & 8.2 në FTD të dosjes së tenderit), bënë shkelje ligjore edhe në vendimin për refuzim, dhe na detyron në si OE që procedurën ankimuese ta vazhdojmë më tutje, ashtu siç lejon LPP, neni 109 duke e dorëzuar këtë Ankesë pranë OSHP-së.

## **2) Pretendimet ankimore dhe faktet mbi shkeljet ligjore në kërkesat teknike dhe profesionale të dosjes së tenderit:**

Në kuadër të kësaj procedure tenderuese, disa prej Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, të paraqitura në neni 8.1 & 8.2 të FTD janë në kundërshtim të plotë me LPP, nenin 7, nenin 28 si dhe nenin 69. Në vijim po paraqesim në mënyrë specifike kërkesat dhe argumentet mbi shkeljet ligjore.

***Kapaciteti teknik dhe profesional:***

**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, (gjeodezike, legalizim) në vlerë minimale prej 100,000 Euro, në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Ose mund të ofrojnë dëshmi se kanë**

**përfunduar dokumentacionin për legalizim për me shume se 50 objekte apo mbi 100,000 m2 ku prej tyre se paku janë 10 objekte te kategorisë II**

***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***

**Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten së paku 6 referenca (3 referenca për kategorinë 1 dhe 3 reference për kategorinë 2) ose certifikatat për kryerje te punëve për legalizim, letër konfirmimin e kërkesave për legalizim se bashku me sipërfaqen dhe kategorinë e objekteve ose vendimet për legalizim ku ceket edhe emri i operatorit**

Dëshmia e kërkuar dokumentare e paraqitur si më lartë është në kundërshtim me vet kërkesën sepse kërkesa specifikon se OE duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (gjeodezike, legalizim), në vlerë minimale prej 100,000 Euro, në 3 (tri ) vitet e fundit, ndërsa dëshmia e kërkuar specifikon vetëm referenca për kryerjen e punëve për legalizim, duke saktësuar se paku 6 referenca. Sipas dëshmive të kërkuara përjashtohen referencat për punët e ngjashme gjeodezike.

**Pretendim 4:** Kjo është në kundërshtim me nenin 69, paragrafi 1, *citojmë:*

***Neni 69:***

- 1. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.***

Nga më sipër është e qartë se dëshmia duhet të sigurohet për të treguar kërkesën për kualifikimet minimale dhe jo duke përjashtuar atë. Andaj, në këtë rast tek dëshmia duhet të specifikohet referenca për punë të ngjashme (gjeodezike, legalizim) ashtu siç është kërkesa.

Për më tepër, specifikimi për 6 referenca (3 referenca për kategorinë 1 dhe 3 reference për kategorinë 2) është krejtësisht në kundërshtim me kërkesën, sepse në kërkesë sasia prej 6 kontratave për legalizim nuk ekziston. Edhe në këtë rast AK shkel LPP, nenin 69.1 si më sipër.

**Pretendim 5:** Sipas fakteve si më sipër, përmes dëshmive të kërkuara, AK ka paraqitur kërkesa në kundërshtim me LPP, nenin 69, paragrafi 1 dhe si e tillë është gjithashtu në kundërshtim me nenin

7 te LPP, paragrafi 1 dhe 2 sepse është kërkesë diskriminuese, dhe mund të eliminojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik.

**Neni 7:**

1. *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
2. *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.*

Përveç të tjerave, matjet gjeodezike për çështje të legalizimit të ndërtimeve pa leje janë shumë të ngjashme me matjet gjeodezike të ndërtesave brenda shumë punëve të tjera gjeodezike, kadastrale, dhe inxhinierisë. Ky është argument shtesë se dëshmia e kërkuar në mënyrë specifike për 6 referenca për punë në legalizim, dhe si e tillë edhe në kundërshtim me vet kërkesën, është vetëm kërkesë diskriminuese dhe aspak ndaj kualitetit të projektit.

**Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin perkates te DT.**

Kërkesa e fundit në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional është kërkesa për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike, të cilat janë paraqitur në Aneksin 6 të dosjes së tenderit.

**Aneksi 6.**

**PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM dhe AFATI PËR KRYERJEN E PUNIMEVE**

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)
1	GPS-GNSS rover	10
2	<b>Stacion Total</b>	<b>5</b>
3	Softuer për përpunimin e të dhënave	1
4	Kompjuter/laptop	15
5	<b>Mjete transporti</b>	<b>5</b>
6	<b>Fluturake pa pilot (dron)</b>	<b>2</b>
7	Software / Programi me licence për projektim	1

**Pretendim 6:** Në aneksin 6, gjegjësisht pikën nr. 6 në tabelë është kërkuar që OE të posedojë 2 Fluturake pa pilot (Dron). Me këtë rast, AK ka vendosur kërkesa në kundërshtim me LPP, nenin 28, paragrafin 2 sepse kërkon pajisje Dron e cila sipas termave të referencës nuk mund të përdoret për matje gjeodezike për legalizimin e ndërtesave pa leje:



Neni 28:

2. *Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik*

Pra, në specifikimet e dosjes së tenderit nuk është lejuar që matjet mund të bëhen përmes Dron. Në Termat e Referencës të dosjes së tenderit, shkruan si në vijim:

### **5.1 Matja e ndërtesës – Situacioni**

Matja e ndërtesave bëhet duke matur minimum tri pika të dy brinjëve të gjata me instrumente për matje GNSS/Stacion Total, ndërsa pikat tjera duhet të krijohen duke matur frontet me distancë matës apo ndonjë metodë tjetër.

Pra, sipas TeR, GNSS/Stacion Total janë instrumentet e vetme për matjet e ndërtesave. Nëse pajisjet Fluturake pa pilot (Dron) nuk mund të përdoren për matjet e ndërtesës, atëherë pse është e nevojshme që OE të posedoj pajisjen në fjalë?

Për më tepër, referuar Kornizën së Punës Nr. AKK 2020/01 për matje, krijim dhe regjistrim të njësive kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës), matjet përmes Dron nuk lejohen për tu përdorur gjatë matjeve gjeodezike për legalizim të objekteve pa leje. Rrjedhimisht është krejtësisht e panevojshme që një OE të posedoj pajisjen Dron. Andaj, kjo është kërkesë në kundërshtim me LPP, nenin 28.2.

### **3) Përfundim**

**Bazuar në deklaratimet si më lartë, në provat dhe faktet e pakontestueshme, kërkojmë nga OSHP, që pas shqyrtimit të provave të paraqitura në këtë ankesë, si dhe në mbështetjet të plotë në LPP-në dhe RRUOPP, të nxjerrë këtë:**

### **VENDIM**

- I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE “Consult Engineering” SH.P.K.
- II. **ANULOHET** njoftimi i AK- KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, i datës 16/05/2022, mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe njoftimi për kontratë i datës 07.04.2022.
- III. **OBLIGOHET** AK- KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES që të bëjë përmirësimin e kërkesave teknike dhe profesionale në përputhje të plotë me LPP.



## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Konsiderojmë se si rezultat i shkeljeve ligjore si më sipër, ne na janë shkaktuar dëme të larta financiare (rreth 45mije euro).**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Në bashkëngjitje të Ankesës janë dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- c) një kopje e njoftimit për vendimin e AK.*
- d) një kopje e kërkesës për rishqyrtim*
- e) një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*